



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 116/13
Prishtinë, më 12.07.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Jelena Bontic.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Imba Rudaku dhe Arbëreshë Kosumi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Minister i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Buxhetit, Qerkin Berisha- MF.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
3. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja, kostatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013**

Kryetarja theksoj se në nenin 1 duhet ndryshohet numri i ligjit, numri “04/L-079” duhet përmirësohet me numrin “04/L-065”.

Propozimi për ndryshimin e numrit 04/L-079, në numrin 04/L-065 në nenin 1, miratohet njëzëri.

Kryetarja, neni 2 kemi rekomandim nga njësia ligjore pranë Kuvendit të cilën e kanë harmonizuar me praktikat e hartimit të ligjeve. Neni 9 është referuar të bëhet në nenin 9 të ligjit bazik. Sugjerojmë që pika 3 të bëhet pika 2a.

Albana Fetoshi mendoj se është e palogjikshme të thuhet të ligjit bazik nëse thuhet ashtu duhet të referohet të ligjit bazik të Republikës së Kosovës. Cilit ligj po i referohemi nëse themi ligjit bazik?

Kryetarja sqaroj se Njësia ligjore ka bërë këtë rekomandim pasi që i referohen në këtë mënyrë. Ligji bazik është projektligji për buxhetin.

Albana Fetoshi poashtu propozoj që neni 2 të fshihet pr shkak se është në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesive.

Naser Osmani mendoj se duhet të jetë në nenin 9 të buxhetit të Republikës së Kosovës, hiqet vetëm pjesa vjetor, pasi që është e ditur se ligji për buxhet është buxhet vjetor.

Albana Fetoshi propozoj që të hiqet pika 3 e nenit 2, propozoj që të hedhet në votim.

Naser Osmani konsideroj se nuk jemi në fazën e votimit por të parimit pasi që jemi në shqyrtim të pjesës tekstuale, ky shqyrtim do të vazhdoj për një javë, pasi të rregullohet teksti do të hyjmë në votim për të gjitha ndryshimet që do të bëhen. Jam shumë i zëshëm sa i përket formulimit, do të diskutohet edhe në aspekt politik për arsye se kjo rrjedh nga marrëveshja dhe e gjithë ajo që vjen nga marrëveshja do të jetë e votuar.

Albana Fetoshi theksoj se nga praktikat e deritanishme të mbledhjeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa çdo herë ka pasur propozime që të hedhen në votim, nuk e kuptoj pse tani nuk kemi të drejtë të hedhim në votim propozimin.

Latif Gashi konstatoi se është mjaft logjik diskutimi i deputetit Osmani, kurse deputetja Fetoshi kur propozon që të fshihet diçka do të ishte mirë të jepet një alternativ tjetër. Neni 2 paragrafi 3 është në përputhje të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesive.

Besim Beqaj vlerësoj se nuk ka kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesive, këto janë tendenca për të thënë se një proces nuk është në harmoni. Ndarja buxhetore është brenda buxhetit të Republikës së Kosovës nuk ka të bëjë asgjë me ligjin, i cili nuk lejon të krijohet fond. Është një ligj i cili ka afatin me ligjin e buxhetit, është një fond i cili është ndarje buxhetore në kuadër të ligjit të buxhetit edhe është në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjesive. Sa i përket bazës legjislative nuk ka shqetësim për të krijuar një ndarje të re buxhetore, e cila do të krijoj që mekanizmat e grumbullimit të parave të bëhen në pjesën veriore dhe që do të mbledhën në Thesar.

Hykmete Bajrami pyet si mund të konsiderohet ndarje buxhetore nëse nuk është në tabelën e Buxhetit? Neni 2 thotë se Fondi Zhvillimor për Veriun të gjitha ndarjet buxhetore janë në tabelën e buxhetit kurse tabela Fondit Zhvillimor nuk është? Nëse të hollat kalojnë përmes sistemit të Thesarit dhe transferohen në një xhirollogari, në një bankë komerciale nuk mund të themi se është ndarje buxhetore. Të gjitha paratë publike të mbledhura prej mallrave të importuara, tatimi në fitim a është para publike? A janë vetëm paratë publike që mbledhen në pikat doganore, nëse është vetëm në pika doganore duhet ta precizojmë. Pra, të mos thuhet para publike sepse ajo përfshinë edhe tatimin në fitim. Problemi kryesor është sesi i përcjellim bizneset?

Albana Fetoshi Ministri theksoj se ligji nuk është në kundërshtim me LMFP, të gjitha paratë që do të mbliidhen edhe do të shkojnë në Fondin Zhvillimor është në kundërshtim me LMFP për shkak se mjetet tregojnë se janë të destinuara për këtë Fond. Thuhet se të gjitha të hyrat të cilat janë të destinuara për konsum në komuna në momentin e hyrjes në Kosovë përmes pikave doganore do të përdoren për Fondin Zhvillimor.

Sali Asllanaj mendoj se është çështje e cila është rregulluar me marrëveshje, e shtyllë e saj është edhe Fondi Zhvillimor, do të doja ta inkorporojmë sa më mirë brenda ligjeve aktuale. Pra, e përkrahi krijimin e këtij Fondin me të cilin pretendojmë se do të zgjedhim një problem të madhe në Veri.

Besim Beqaj sqaroj se për çështje të menaxhimit ka institucione të cilat merren me menaxhimin e situatave ekonomike, është bërë vlerësimi se egziston stabiliteti makrofiskal dhe disiplina fiskale. Ky fond është produkt i Marrëveshjes, është ndarje buxhetore e cila me buxhet e ka kodin 252, janë mjete të dedikuara por nëse lexohet amendamenti në tërësi thuhet se mjetet që grumbullohen në Fondin e Kosovës do të shkojnë në Thesar dhe në kuadër të sistemit të integruar të menaxhimit të financave të Kosovës do të ndahen me kodin e paraparë buxhetor. Kurse sa i përket destinimit të mjeteve duhet të dijmë se në Kosovë ka inspeksione të ndryshme, secili inspektor e bënë vërtetimin e gjendjes së ndërmarrjes që ka blerë mallra me dedikim për një hapësirë të caktuar. Nëse këto mallra janë ritregtuar është çështje që mund të evidentohet me ligj në çdo kohë, ndërsa mallrat që do të ç'doganohen sepse ka pasur ide të tilla pse nuk i kemi hequr mjetet nga Buxheti për aq shumë sa ka Fondi nuk është e saktë, pasi që Fondi do të krijoj të hyra edhe për Buxhetin e Kosovës. Do të ketë të hyra shtesë edhe për Fondin edhe për Buxhetin pra, ndarja buxhetore ekziston.

Kryetarja tek neni 3 , kemi dy propozime nga ministria e financave, ku rekomandohet që paragrafi 3 i nenit 3 të fshihet në tërësi , d.m.th është fjala për fondin për shpenzime kontingjente të cilat janë të ndara për rezervën komunale.

Besim Beqaj Ligji për kufijtë administrativ të komunave ka qenë në shqyrtim në Kuvend dhe ligji është tërhequr nga procedura me kërkesë të kryeministrit dhe tani ky nen nuk ka hapsir për shkak se nuk do të bëhen ndarje buxhetore për komunat e reja me qenë se ligji është tërhequr.

Kryetarja konstatoj se komisioni njëzëri rekomandoi që paragrafi 3 i nenit 3, të fshihet.

Kryetarja propozimi tjetër i mimnistrisë është që paragrafi 4 i nenit 3 të ndryshohet si në vijim: ndarjet kontingjente në Ministrinë e Financave për financimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politik mund të shpenzohen për këta përfitues ,dhe të transferohen në MPMS, vetëm pasi të kemi një vendim të aprovuar të Qeveris. Ndarjet mund të shpenzohen vetëm pas kompletimit të vlerësimit fiskal i cili vlerësim mbulon periudhën prej më së paku pesë vite dhe përfshin verifikimin e përfituesve. Do të ishte mirë që Ministri të na shpjegojë pse ka shkuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes sociale sepse po kom reagime nga të burgosurit politik pse nuk ka shkuar në Ministrinë e Drejtësisë .

Besim Beqaj ne kemi harmoni me FMN në këtë paragraf i cili përveç vendimit të qeverisë i cili duhet të jetë dhe për të kaluar këto mjete në Ministrisë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale duhet vlerësimi fiskal dhe verifikimi i përfituesve kështu që është çështje procedurale. Ne kemi diskutuar edhe brenda përbrenda që të gjitha ndarjet që shkojnë për kategori të ndryshme është pjesë e MPMS, janë transfere të cilat kryhen dhe nuk ka ndonjë bazë që shkojnë nëpër kategori tjetër, mirëpo nuk ka bazë që të shkojnë ne Ministrinë e Drejtësisë.

Albana Fetoshi këtu thuhet se shpenzimet për këta përfitues transferohen vetëm pasi ta kemi një vendim të Qeverisë, a nuk kish mund të precizohet kur do të jetë vendimi i Qeverisë për këtë çështje dhe ky ligj vlenë vetëm për gjashtë muaj.

Besim Beqaj ne nuk mund të vendosim diçka në buxhet përderisa nuk e kemi listën e saktë të përfituesve dhe sasinë e mjeteve që ata përfitojnë, kjo është çështje që duhet që bëhet bashkë me shoqatën dhe pasi ta kemi listën e plotë të ndikimit dhe vlerësimit financiar atëherë mund të shëndrrohet në vendim të Qeverisë dhe mjetet të bëhen efektive.

Naser Osmani Së pari nuk është letë të bëhet lista e ishe të burgosurve politik për arsye se ish i burgosur politik prej cilës datë është ish i burgosur politik , dhe ka të burgosur politik dhe të trajtuar njerëz të keqtrajtuar politikisht sa do të shkojë periudhë e gjatë deri sa të bëhet një statistikë e kartë. Qeveria duhet me nxjerrë një vendim se kjo 2 milion euro i shpërndahen 2000 personave p.sh dhe qeveria me atë vendim e specifikon mënyrën e ndarjes se a i ndanë në mënyrë linear a i ndanë sipas moshës apo sipas ditëve në burg.

Kryetarja konstatoj se miratohet propozimi i Ministrisë së Financave për riformulin e paragrafit 4 të nenit 3 si në vijim:

4. Ndarjet kontrigjente në Ministrinë e Financave për Financimin e ish të denuarëve dhe përndjekurve politik mund të shpenzohet për këta përfitues dhe transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), vetëm pasi të kemi një Vendim të aprovuara të Qeverisë. Ndarjet mund të shpenzohen vetëm pas kompletimit të vlerësimit fiskal, i cili vlerësim mbulon periudhën prej më së paku 5 viteve dhe përfshinë verifikimin e përfituesve.

Paragrafët 3, 4 dhe 5 të ligjit bazik, rriemrohen si paragrafët 4, 5 dhe 6.

3. Të ndryshme

Kryetarja njoftojë se do të caktohet të hënën një mbledhje për shkak se ka ardhur pakoja e ligjeve për liberalizimin e vizave dhe për një projektligj që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politik, jemi komision funksional dhe duhet të shqyrtojmë në parim. Po ashtu në këtë takim do të shqyrtohet edhe Raporti i BQK-së për vitin 2012, që u shtye nga mbledhja e fundit.

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona

